

**SEMINAR  
PËR IDENTIFIKIMIN, SEKUESTRIMIN DHE KONFISKIMIN E PASURIVE TË KRIJUARA NGA  
TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE, 17 Prill 2013**

**Fjala e Kryetarit të Prezencës së OSBE**

Zv. Ministër Noka,  
Zj. Snajderova,  
Të nderuar të ftuar,

Si Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, kam kënaqësinë e madhe t'ju uroj mirëseardhjen në këtë seminar të organizuar së bashku me Ministrinë e Brendshme.

Më lejoni të përmend së pari kolegët tanë nga Njësia e Sekretariatit të OSBE-së për Çështje të Posaçme Policore, kontributi dhe mbështetja e vyer e të cilëve do t'i pasurojë diskutimet. Ata kanë eksperiencë të madhe në mbështetjen e Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së në shfrytëzimin e mjeteve dhe mënyrave kundër pastrimit të parave në luftën ndaj krimeve si trafikimin i qenieve njerëzore.

Dëshiroj, gjithashtu, të përmend e të falënderoj ekspertët ndërkombëtarë nga Njësia e Hetimit Financiar të Lihtenshtajnit, qendrën e Mbretërisë së Bashkuar kundër trafikimit dhe policinë zvicerane, si dhe OPDAT-in. Mezi presim të dëgjojmë mësimet që ata kanë nxjerrë dhe praktikat më të mira, nisur nga rezultatet pozitive që ata kanë arritur në hetimin financiar të trafikimit të qenieve njerëzore.

Dëshiroj t'ju uroj të gjithëve mirëseardhjen nga ana ime.

Për mendimin tim, pjesëmarrja e gjerë e institucioneve relevante këtu, tregon potencialin për një përgjigje të përbashkët të të gjithë institucioneve dhe aktorëve, si dhe angazhimin e tyre për ta luftuar mjaft fort trafikimin.

Ndonëse kemi ndër mend të fokusohemi në aspektet financiare në këtë seminar, më lejoni të kujtoj atë që është problemi kryesor: trafikimi i qenieve njerëzore është një krim i rëndë. Ai përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. U shkakton dëme serioze viktimave të trafikuar.

Përveç kësaj, ai përbën edhe një kërcënim ndaj sigurisë dhe paraqet implikime përtej kufijve dhe është shpesh i lidhur me kërcënime të tjera, si për shembull krimi i organizuar. Si i tillë, ai është shqetësim jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për gjithë rajonin e gjithë Evropën, duke

pasur parasysh rrjetet kriminale të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore. Kjo krijon nevojën e reagimeve të përbashkëta.

Për fat të keq, mund të përballemi edhe me një rritje të trafikimit të qenieve njerëzore, po të kemi parasysh ndikimin e krizës ekonomike. Siç thekson edhe një raport i kohëve të fundit të EUROPOL-it, kushtet e vështira ekonomike kanë rritur përgjithësisht kërkesën për tregje të paligjshme pune, situatë që shfrytëzohet nga grupet e organizuara kriminale.

Trafikimi i qenieve njerëzore përshkruhet shpesh si një krim 'me fitime të mëdha dhe risk të vogël', për shkak të fitimeve të mëdha që ai gjeneron dhe të sfidave me të cilat përballen organet e zbatimit të ligjit në identifikimin e qarkullimit të parave, të cilat shpesh investohen në ekonomi të ligjshme ose në forma të tjera trafikimi.

Për këtë arsye, qasja e ndjekur në këtë seminar, kombinimi i njohurive dhe ekspertizës së agjencive që luftojnë kundër pastrimit të parave me atë të atyre që punojnë në sektorin kundër trafikimit, është qasja më pozitive. Ajo do të ndihmojë në eksplorimin e opsioneve të ndryshme, në mënyrë që konfiskimi i këtyre të ardhurave të forcojë parandalimin e trafikimit duke reduktuar fitimet nga aktivitetet kriminale.

Së dyti, ky seminar duhet, gjithashtu, të eksplorojë se si mund të bëhet dëmshpërblimi i viktimave një zgjidhje efikase, qoftë nga shteti, qoftë drejtpërdrejt nga trafikantët.

Vitet e fundit, Shqipëria ka ndërmarrë përpjekje të konsiderueshme që duhen vlerësuar në luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në nivel legjislativ dhe operativ. Ndryshimet e propozuara në Kodin Penal duhet të rrisin numrin e ndjekjeve penale të të gjitha formave të trafikimit të qenieve njerëzore, pavarësisht nëse ai ndodh brenda për brenda vendit apo përtej kufijve, dhe pavarësisht nëse ai përfshin shfrytëzimin e punës, lypjes apo prostitucionit.

Zv. Ministër Noka,  
Zj. Snajderova,  
Të nderuar të ftuar,

Lufta ndaj krimit kërkon bashkëpunim më efikas, në vend dhe jashtë tij.  
Bashkëpunimi ndërkufitar me autoritetet të anti-trafikimit të vendeve fqinje është thelbësor.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri është e gatshme të asistojë në përpjekje të tilla, edhe mes misioneve të tjera të OSBE-së në terren dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Për më tepër, në këtë kuadër sfidash serioze dhe burimesh të kufizuara, bashkëpunimi mes organeve të ndryshme është i domosdoshëm. Mendoj se shembulli pozitiv i Memorandumit të Bashkëpunimit nënshkruar së fundmi për konfiskimin e pasurive të krimit të organizuar dhe pastrimit të parave është një shembull, ku ia vlen të mbështetemi.

Unë shpresoj që ky seminar të jetë një hap i vlefshëm drejt forcimit të veprimeve të përbashkëta në këtë fushë.

Pres me kënaqësi të shoh diskutime konstruktive dhe frymëzuese dhe hartimin e propozimeve praktike.

Faleminderit!